



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe

STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA:

Onomastika e fshatrave malore të Komunës së Vrapçishtit

(Gjurgjevisht, Llomnic, Kalisht, Gorjan)

Kandidati:

Zijad Shabani

Mentor:

Prof.dr. Zeqir Kadriu

Tetovë,2018

PASQYRA E LËNDËS

MIRËNJOHJE.....	6
HYRJE.....	8
TOPONIMIA DHE NDARJA E SAJ	10
Toponimet dygjuhësore.....	12
Lënda e hulumtimit.....	13
2. Qëllimet e hulumtimit.....	14
Hipotezat.....	15
Metodologjia e hulumtimit.....	16
Rëndësia e punimit	17
HYRJE.....	19
KOMUNA E VRAPÇISHTIT	19
Pozitat gjeografike dhe historiku i komunës së Vrapçishtit	19
TAB.1. VENDBANIMET E KOMUNËS SË VRAPÇISHTIT SIPAS NDARJES SË RE.....	21
Historiku i popullimit.....	22
KREU I.....	23
MIKROTOPONIMET SIPAS FSHATRAVE	23
FSHATI GJURGJEVISHT	23
Mikrotoponimet e fshatit Gjurgjevisht:	26
Hidronime	27
FITONIMET	28
Zoonine	29
2.FSHATI LIOMNICË.....	30
Pozita gjeografike:.....	30
Mikrotoponimet e Fshatit Llomnicë	32
3.FSHATI KALISHT.....	35
Pozita gjeografike.....	35
Mikrotoponimet e fshatit Kalisht.....	37
4. FSHATI GORJAN.....	40

Poziata gjeografike:.....	40
Mikrotoponimet e fshatit Gorjan.....	41
Mikrotopime	43
Mikrotoponime me origjinë shqiptare:	47
Mikrotoponime me origjinë sllave:.....	48
Mikrotoponime me origjinë turke:	48
Mikrotoponime të përziera.....	48
Mikrotoponime tjera:	49
Klasifikimi i mikrotoponimeve sipas origjinës:.....	50
Klasifikimi i mikrotoponimeve:	51
KREU I DYTË.....	55
ONOMASTIKA E FSHATRAVE MALORE TË KOMUNËS SË VRAPÇSHTIT NGA PIKPAMJA LEKSIKO SEMANTIKE (Gjurgjevisht, Llomnic, Kalisht dhe Gorjan).....	55
2.HIDRONIMET	56
3.MINERALOGJIA.....	56
4.FITONIMET	56
5.ZOONIMIA.....	57
6. KOMUNIKACIONI.....	57
7. OBJEKTE.....	57
8.PROFESIONE.....	57
9. EMRA NJERËZISH.....	57
2.1 Mikroponime të formuara prej mbiemrave që përcaktojnë formë, madhësi, pozitë, ngjyrë, moshë, temperaturë dhe veçori të tjera.	59
2.2 Mikrotoponimia me numërorë.....	60
2.3 Mikrotoponimia me folje	60
2.4 Mikrotoponimia me ndjfolje	60
2.5 Mikrotoponima me parafjalë	60
KREU I TRETË	61
FJALORTH SHPJEGUES ONOMASTIKË.....	61
Përfundime	71
LITERATURA E SHFRYTËZUAR.....	73

Informatorët	75
PËRMBLEDHJE	77
SUMMARY	78
РЕЗИМЕ.....	79

MIRËNJOHJE

Dua të falenderoj të gjithë përkrahësit e mi të cilët kontribuan për të dalë në dritë puna ime e magjistraturës. U jam shumë mirënjohës profesorëve të mi të studimeve si prof.dr Vebi Bexheti, prof.dr. Hamit Xhaferi, prof.dr Mustafa Ibrahim, prof.dr Luljeta Adili- Çeliku, prof.dr. Meral Shehabi, prof dr. Jehona Rushidi-Rexhepi pa mos e harruar mentorin tim të kësaj teze i cili me këshillat e tij, ka qenë inercioni i vullnetit tim përgjatë gjithë kohës së punimit. I pa kursyer në kohë dhe hapsirë, motivues dhe lojal, i gatshëm për ndihmë dhe përkrahje akademike shumë i respektuari im prof.dr Zeqir Kadriu.

Falenderime shumë të sinqerta u dedikoj grupit tim të masterit të cilët më kanë përkrahur moralisht në çdo vështirësi. Falenderimi im jetik shkon për familjen time, përkrahja e tyre ka qenë e pazezervë deri në përfundimin e studimeve të mia. Një falenderim i pashoqë për ndihmën dhe motivin që kisha gjatë gjithë punës sime, e falenderoj përjetësisht atë që nuk arriti të jetë sot në kurorëzimin e mundit tim! Nënë time të ndjerë... Zoti e mëshiroft!, Ku në ulësn, në vend të saj, sot vendosa një lule, sepse sakrificat e saj për mua meriton që unë biri saj më i vogli e më i madhi, të lutem që shpirti t'i prehet në paqe, e qetë mes luleve të Parajsës.

Thellësisht mirënjohës u jam informatorëve të mi, pa të cilët ky punim do të ishte shumë i zbehtë, me shumë modesti dhe shenjë falenderimi u kam kushtuar një rubrikë në fund të këtij punimi të gjithë atyre që u bënë bashkëautor me mua deri në fund të punës sonë. Mirënjohje të gjithë stafit drejtues pranë UEJL-s, e në veçanti administratës së Fakultetit të Gjuhëve Kulturave dhe Komunikimit. Pafundësisht mirënjohës udhëheqësisë së universitetit më prestigjios në rajonë e më gjërë, shtëpisë sime të dytë, Universitetit të Evropës Juglindore, i cili më dha titull dhe më bëri ky që jam sot, krenar për vitet e kaluara pranë këtij tempulli të shenjtë të dijes. I uroj jetë të gjatë dhe prestigj deri në mesin e universiteteve më prestigjioze të botës.

Abstrakt

Fusha e studimit të thelluar e karakterit gjuhësor, në një hapsirë relativisht të panjohur mire nga aspekti gjuhësor, na motivon që edhe më fuqishëm t'i qasemi këtij studimi. Mikrotoponimet, si përmendore të kujtesës njerëzore kanë një rëndësi të veçantë për autoktoninë e një populli dhe mënyrën e të jetuarit. (Ibrahimi.M 2010:11)

Ambiciet tona në këtë fushë janë të shfrenuara, kur e dime se kemi të bëjmë me një hapsirë të pashkelur më parë nga këndvështrimi i kësaj natyre studimi. Rëndësia e mikrotoponimeve për lëndën e gjuhësisë paraqet po aq interesim sa zbulimi i fosileve për arkeologjinë.

Komuna e Vrapçishtit është komunë që shtrihet në pjesën Veriperendimore të Maqedonisë. Qendra e komunës gjendet në Vrapçisht. Në këtë komunë gravitojnë fshatrat fushorë që shtrihen në Veriperendim të Fushës së Pollogut si: Gradeci (fshat i parë që kufizohet me komunën e Bogovinës nga ana Lindore), Sanakosi, Negotina (e Pollogut), Dobridolli, Toplica, Gallata, Vrapçishti dhe Zubovca. Ndërkaq, fshatrat malore që të gjithë shtrihen në Malin Sharr dhe si të tillë i kemi për objekt studimi, po i paraqesim duke i rradhitur nga lindja drejt perendimit; shtrihen si vijon: Gorjani, Gjurgjevishti, Llomnica, Kalishti, Pozharani, Përshefca, Novosella dhe Vranjovca.

Duke qenë se edhe kjo hapsirë malore nuk ka mundur t'ju shmanget huazimeve gjuhësore që i gjejmë nga gjurmët e perandorive të ndryshme, si: Otomane e sllave. Prandaj si rezultat i kësaj dukurie, mikrotoponimet i kemi klasifikuar edhe sipas origjinës nga vijnë si: Ilire, sllave, turke, dhe shqiptare. Ky punim shpresojmë që të shërbejë si një gurë në kalanë e thesarit gjuhësorë, sepse këtu do të gjejmë emërtime toponimike e mikrotoponimike nga stadi të ndryshme të historisë së njerzimit.

Fjalët kyçe: *Onomastika, toponimet, mikrotoponimet, dukuri fonetike, morfologjike, sociolinguistike, dialektologjike, etimologjia, legjenda, kultura, fitonime, fauna, hidronime etj.*

HYRJE

Ndër hapat e parë të kërkimeve rreth shpjegimeve historike për gjuhën shqipe dhe në fazat e herëshme të zhvillimit të saj, kanë qenë pikërisht emrat e viseve dhe përgjithësisht onomastika e përmendur nëpër mbishkrime, pastaj edhe nëpër shkrime të ndryshme, që kanë pasur rolin e dëshmuar të pranishëm të shqipes e të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme. (Shkurtaç 2001:7)

Me studime *onomastike* janë marrë studiues më në zë të albanologjisë si: E.Çabej, M.Domi, R. Ismaili, I Ajeti. A. Kostallari, P. Daka, K. Luka etj. Gjatë studimeve të tyre gjuhësore vëmendje të veçantë i është kushtuar të dhënave *onomastike*. Hulumtimet e tyre shkencore kanë qenë të përkushtuara rreth emrave të viseve (toponimeve), emrave të njerëzve (antroponimeve), dhe emrave familjarë (patronimeve).

Onomastika është degë e gjuhësisë që studion emrat e përveçëm të vendeve dhe të njerëzve. Përfshin dy fusha kryesore: toponiminë dhe antroponiminë. Onomastika shqiptare ndihmon për sqarimin e mjaft çështjeve nga fusha e historisë, arkeologjisë, etnografisë, folklorit, gjeografisë etj. Si në rrafshin diakronik ashtu edhe në rrafshin sinkronik.

Për ta kuptuar perspektivën e gjuhës, mjaftë të rëndësishme janë dukuritë onomastike, sepse toponimet janë pjesë përbërëse e trashëgimisë historike-kulturore. Gjatë gjithë shek.XIX, përveç gjuhësisë, shpjegimi i toponimeve ishte mbështetje e sigurtë për studimet historike të epokave më të herëshme. Për një kohë shumë të shkurtër *onomastika* do të zë një vend të rëndësishëm në gjuhësi, duke u renditur si disiplinë e veçantë. (Ibrahimi 2012:234).

Onomastika ndryshe mund të llogaritet si *arkivi gojorë* i çdo gjuhe, nga e cila mund të mësojmë mbi lashtësinë kulturën dhe lidhshërinë e të tashmes me antikitetin, e në veçanti shqipja si pasardhëse e ilirishtes, këtë më së miri na e vërtetojnë toponimet që janë të barazvlefshme me fosilet për arkeologjinë, e cila na mëson për autoktoninë e një populli apo vendi. Toponimet e ruajtura me formën e tyre të hershme shërbejnë si dëshmi për lashtësinë e një populli. (Halimi 1993:10).

Toponimia- paraqet studim shkencor mbi emrat e vendeve, origjinën e tyre, kuptimin, përdorimin dhe tipologjinë. Emri *topós* (τόπος) rrjedh nga greqishtja që do të thotë vend dhe *ónoma* (ὄνομα), që do të thotë emër, pra shqip *emri i vendit*.

Faktorët që ndikojnë në ndryshimin e emrave (*toponimeve*) janë të nduarnduarshëm si:

a) ndërrimi i sunduesit, b) pikpamja ideologjike, c) pikpamja historike si dhe d) pikpamja gjuhësore. Nga pikpamja e ndërrimit të sunduesëve dhe lindja e toponimeve shumëgjuhësore kanë lindur si rezultat i trysnisë asimiluese nga sunduesë të caktuar. **Psh: Raguzë** (P.Bizantine), nga fundi i Luftës së Parë Botërore (**Dubrovniku-kroat**). Ose **Viena**, guri i çmuar i Austrisë, në shek.IX u morë nga Hungaria dhe u emërtua **Beç** (kështu edhe sot e kësaj dite e quajnë serbët dhe kroatët) dhe plot e përplot raste të tilla kemi nëpër botë. Sipas pikpamjeve ideologjike zakonisht përcaktohen për një formë të pastër leksikore se sa për një huazim, zanafillën e këtyre emërtimeve e kemi nga koha shteteve të e sistemit ish-socialist të cilët i riemëronin (zëvendësonin) toponimet me emrat e personaliteteve të jetës politike e shkencore, e me çërast u krijuan toponime ideologjike si: Sankt-Petersburg>Leningrad ose Veles>Titoveles etj.

Nga këndvështrimi historik, në Gadishullin Ballkanik kemi një numër të madh *oronimesh* që vijnë nga substrati ilir ku qartë shihet diferencimi paraslloven substrope. Ku ndikim ilir më së miri shihet te apelativi ***mal**: *Malezi, Mal të zi, por edhe në emrat: Dalmaci, Dardani, Dimalum, Ulqin, Vendum, Vis, Budva, Dukla, Tara, Zara, Butrint, Theranda, Shkupi, Shtipi, Sharri, Shkodra, Nishi.* (Ibrahimi 2012:238)

Nag pikpamja gjuhësore, si në çdo gjuhë tjetër, edhe në gjuhën shqipe kemi ndryshime të toponimeve përgjatë shejkujve, ndërkaq tek disa kemi vetëm ndryshime fonetike. Duke krahasuar format e moçme të toponimeve me të sotmet, mund të vërejmë se toponimia shqiptare ka pasur një evolucion të natyrshëm sipas ligjeve fonetike të shqipes, njësoj si fjalët e tjera. Psh: kalimi i s në **sh**: Scodra>Shkodra, Scupi>Shkup, Lissus>Lesh>Lezhë. Apo edhe ndryshime tjera si: Durrachium>Durrësi, Arachtos>Arta etj. (Shkurtaç 2001:29).

TOPONIMIA DHE NDARJA E SAJ

Toponima ka dy ndarje: *Makrotoponimet dhe mikrotoponimet*. **Makrotoponimet** paraqesin emrat e vendeve më të mëdha. **Mikrotoponimet** paraqesin nomenklaturën e vendeve të vogla lokale si: Malet, fushat, apo pjesët e pyejeve. Tregon një tipar të vogël natyror (p.sh: Një fushë, rrugë, urë, etj). Mikrotoponimet, si përmendore të kujtesës njerëzore kanë një rëndësi të veçantë për autoktoninë e një populli dhe mënyrën e të jetuarit, rëndësi kanë edhe për disiplinat tjera gjuhësore dhe jashtëgjuhësore si dialektologjinë, gjuhësinë, historinë etj. (Ibrahimimi 2010:11). Duke u bazuar në realitetin gjeografik apo administrativ që shënojnë, toponimet grupohen në:

-**Oikonime** (emrat e vendeve të banuara, ku bëjnë pjesë dhe etnonimet),

-**Hidronime** (emërtimet e ujrave) dhe

-**Oronimet** (emrat e maleve, kodrave, tokave, fushave).

Toponimet ndryshe mund të quhen edhe si “ Kodëzime të quajtjes” që lindin për shkak të nevojës së njerëzve, çdo vend në një teritor të caktuar të ketë emrin e vet, dhe të ketë domethënie. Këto emra të vendeve, shoqërisë i shërbejnë për t’u orientuar në mjedisin ku jetojnë. Prandaj çdo mikrotoponim në vete fsheh një *gojëdhënë*, një *mit* apo ndonjë ngjarje që lidhet me ndonjë të vërtetë. Prandaj shpesh ndodh që rrethinat të kenë larmi mikrotoponimesh, shumë herë po aq të rëndësishme sa edhe makrotoponimet. (Shkurtaj 2001:66).

Duke u nisur nga klasifikimi semantik, toponimet ndërtohen mbi bazën e disa motiveve semantike:

1.Përshkrimi sipas tipareve të caktuara që lidhen me ngjyra, forma, përmasa në bashkëlidhje a krahasim në objekte tjera të së njëjtës fare.

2. Përshkrimi mbi bazë të metaforës dhe tropeve gjuhësore.

3. Emërtimet shprehëse ose mbi bazën e fantazize dhe besëtytënyve.

Sado që të orvatemi e të mbledhim materiale onomastike të trevës që e kemi për objekt studimi, përsëri nuk mund të themi se është thënë gjithçka. Ka edhe shumëçka për t’u thënë e për

t'u bërë, pasiqë lëmia onomastike e këtij rajoni është një gurrë e pashterëshme. Kushdo që vjen të lëvrojë në “ Arkivin gojor” të këtyre vendbanimeve malore nuk do të kthehet duarboshë.

Që nga koha e studimeve të mia fusha onomastike e ka mbajtur të ndezur vazhdimisht kureshtjen time për t'u thelluar sa më shumë brenda një territori relativisht të hulumtuar nga këndvështrimet gjuhësore. Kjo dukuri edhe më shumë na zgjonte interesimin për t'u futur në botën e zbulimit të thesarrit gjuhësor.

Me plotë përkushtim e kemi aplikuar projektin tonë në terren përmes punës empirike përgatitjes së pyetësorëve dhe kontaktik nëpër vendbanime me informatorë që janë një numër jo i vogël. Kemi aritur që të bëjmë mbledhjen, klasifikimin dhe paraqitjen e tyre gjatë këtij punimi me një pasqyrë lakonike për të gjithë të dhënat e mbledhura. I pakushtëzuar dhe i pakursyer ka qenë kontributi i mentorit tim Prof.dr.Zeqir Kadriu të cilit i jam shumë mirënjohës, që gjatë gjithë periudhës së punës sonë, nuk ka hezitur të na ndihmojë me përvojën e tij akademike-shkencore. Kemi konsultuar një sërë burimesh nga informatorë dhe botime librash të karakterit gjuhësorë në lëminë e onomastikës.

Ndër të tjera si material bazë kemi shfrytëzuar veprat: Xhemaludin Idrizi “Mikrotoponimia e Karshijakës së Shkupit”, Shkup,2017; Bahtijar Kryeziu “Onomastika e Hashanisë” ,Prishtinë, 2000; Mustafa Ibrahimimi “Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të rrethit të Prilepit, Krushevës dhe Velesit” , Shkup, 2010; Qemal Murati “Fjalor Toponamastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë”, Tetovë 2008; Mehmet Ahmetaj “Gjurmimë Onomastike”, Prishtinë, 2009; Begzat Baliu “Onomastika dhe Indetitetët”, Prishtinë, 2012; Mustafa Ibrahimimi “ Gjuhë dhe Kulturë”, Shkup, 2016; Izmit Durmishi “Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit”, Gostivar, 2007; Hasan Hoda “Negotina me rrethinë”, Tetovë,1995; Ismet Jonuzi-Krosi “Jeta dje dhe sot në luginën e Pollogut”, Burime nga interneti dhe një sërë punimesh gjuhësore të karakterit gjuhësor onomastik të botuara nëpër revista dhe përmbledhje kumtesash.

Puna në terren, studimi empirik, ballafaqimi me zona të panjohura bënë që puna jonë të kryhet me një interes të veçantë. Ballafaqimi me emërtime të formave të vjetra fjalësh e me kuptime të fosilizuara, gjurmë mesjetare, relikte elementesh, greke, latine, sllave, turke etj, bëjnë që struktura e këtij punimit të duket si një mozaik shumdimensional.

“Toponima duhet bërë në teren. Këtë proces më së miri e pasqyrojnë veprat e botuara deri më tani, gjejmë të dhëna shumë të rëndësishme për onomastiken shqiptare, një lëndë e vlefshme që mund të plotësojë në masë të madhe mungesën e dokumenteve të shkruara” (Gj.Shkurtaç).

Toponimet dygjuhësore. Si pasojë e nacionalizmit gjuhësorë, toponimet më të shpeshta dygjuhësore shqip-sllavisht i hasim në Kosovë, dhe në trevat shqiptare të Malit të Zi dhe Maqedoni. Kjo dukuri vjen si rrjedhojë e infiltrimit të gjuhës së administratës dhe e dyta nga fakti se shqiptarët dhe sllavet gjatë shekujve kanë jetuar në rrethana historike të ngjajshme, kanë pasur institucione shoqërore të ngjajshme dhe ndoshta është njëfarë bashkegjzistence.(Ajeti 1978:351). Toponime me tendencë diskriminuese kemi gjithandej në trevat shqiptare të Maqedonisë që datojnë nga Luftërat Ballkanike dhe instalimi i pushtetit të Mbretërisë SKS. Kësaj dukurie nuk kanë mundur t’i shmangen as vendbanimet më të thella malore siç janë vendbanimet që i kemi për objekt studimi gjatë këtij punimi. Shqiptarët e Maqedonisë me dekada ishin të detyruar t’i përdorin toponimet sllave siç janë: Skopje, Bitola, Kiçevo, Debar, Ohrid etj, në vend të trajtave shqipe si: Shkup, Manastir, Kërçovë, Dibër, Ohër etj.

Nëse lufta është vazhdim i politikës me mjete tjera, atëherë politika gjuhësore paraqet formën më të butët të luftës midis dy popujve. Çdo kohë e sjell një repertor të vetin të emërtimeve, ashtu si çdo rajon në kuadër të gjuhës së vet ka vetitë dhe karakteristikat e veta. Në toponimi ky thesar i pasur leksikor, duhet të ruhet dhe mëkëmbet.

Krijimtaria popullore me fanatizëm i ruan dhe kultivon, në mënyrën e vet i përzgjedh, duke i eliminuar dhe duke i mbajtur të gjallë. Por megjithse shumë toponime janë imponuar me anë të masave represive ose pushtuese, është koha që një pjesë të zëvendësohen me emra nga gurra popullore si shenjë e identitetit të një populli.(Ibrahimi 2012:242).

Lënda e hulumtimit

Laramania e emërtimeve toponimike dhe mikrotoponimike ngjallin interes të veçantë për një studim të mirfilltë shkencorë. Fusha e studimit të thelluar e karakterit gjuhësor, në një hapsirë relativisht të panjohur mire nga aspekti gjuhësor, na motivon që edhe më fusqishëm t'i qasemi këtij studimi. Mikrotoponimet, si përmendore të kujtesës njerëzore kanë një rëndësi të veçantë për autoktoninë e një populli dhe mënyrën e të jetuarit.(Ibrahimi.M 2010:11)

Rëndësia e mikrotoponimeve për lëndën e gjuhësisë paraqet po aq interesim sa zbulimi i fosileve për arkeologjinë. Ambiciet tona në këtë fushë janë të shfrenuara, kur e dime se kemi të bëjmë me një hapsirë të pashkelur më pare nga këndvështrimi i kësaj natyre studimi.

Komuna e Vrapçishtit është komunë që shtrihet në pjesën Veriperëndimore të Maqedonisë. Shtrihet rrëzë malit Sharr në një lartësi mbidetare prej 580m. dhe me një largësi prej qytetit të Gostivarit prej 6km Qendra e komunës gjendet në Vrapçisht. Ky vendbanim përmendet në dokumentet e shkruara tureke që nga viti 1462¹. Sipas regjistrimeve të vitit 1545, Vrapçishti ka pasur 233 familje të krishtera, 15 muslimane dhe 54 të islamizuara. Kurse sipas atij të vitit 1568 -243 familje të krishtera, 17 muslimane dhe 3 të islamizuara².

Sipas regjistrimeve të mëvonshme të popullsisë Vrapçishti ka këtë pasqyrë:

1971-608 shtëpi 4047 banorë

1981-829 shtëpi 5011 banorë

Dhe sipas regjistrimit të fundit të vitit 2002 fshati numëronte 1049 familje dhe 4874 banorë³. Me ndarjen territoriale të vitit 1996 u shpall komunë më vete.

Në këtë komunë gravitojnë fshatrat fushorë që shtrihen në Veriperendim të Fushës së Pollogut si: Gradeci (fshat i parë që kufizohet me komunën e Bogovinës nga ana Lindore),

¹ J.F.TRIFUNOSKI-ANTROPOGEOGRAFSKA PROUČUVANJE, BEOGRAD 1976,F.197

² Тур.Док.За ист. На мак.Нар.опш. поп.дефт од XV век, Том III,Скопје, 1976. f, 138

³ Librat e regjistrimit të vitit 1971-81 dhe 2002, Kuvendi I Komunës së Gostivarit- Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë.

Sanakosi, Negotina (e Pollogut), Dobridolli, Toplica, Gallata, Vrapçishti dhe Zubovca. Ndërkaq, fshatrat malore që të gjithë shtrihen në Malin Sharr të lidhura dorëpërdore mes veti si qafore të varrura mbi kodrat dhe rafshlartat e malit. Si të tillë po i paraqesim duke i rradhitur nga lindja drejt perendimit, shtrihen si vijon: Gorjani, Gjurgjevishti, Llomnica, Kalishti, Pozharani, Përshefca, Novosella dhe Vranjovca.

Ky punim shpresojmë që të shërbejë si një gurë në kalanë e thesarit gjuhësorë, sepse këtu do të gjejmë emërtime toponimike e mikrotoponimike nga stadi të ndryshme të historisë së njerzimit. Duke qenë se edhe kjo hapsirë malore nuk ka mundur tëju shmanget huazimeve gjuhësore që i gjejmë nën gjurmët e perandorive të ndryshme, Otomane e sllave. Prandaj si rezultat i kësaj dukurie, mikrotoponimet i kemi klasifikuar edhe sipas origjinës nga vijnë si: Ilire, Sllave, turke, dhe shqiptare.

2. Qëllimet e hulumtimit

Hapsira gjeografike të cilën e kemi përcaktuar si objekt studimi zgjon një interes të theksuar për më shumë disiplina gjuhësore si sociologjike, dialektologjike, leksikologjike, gramatikore (fonetik, morfologji) etj.

Studimet paraprake që i janë përkushtuar kësaj ane janë kryesisht përmbledhës në vija të trasha por, që na ndihmojnë për ti lëvizur më tutje studimet e mirëfillta gjuhësore. Teza ime mbi

Onomastikën e fshatrave malore të Komunës së Vrapçishtit

(Gjurgjevisht, Llomnic, Kalisht, Gorjan)

është qasje e parë e hulumtimit të kësaj natyre gjuhësore.

Metodat empirike dhe pyetësorët e ndryshëm që i kemi përpiluar pikërisht për këtë problematikë do të jenë një inercion i fuqishëm drejt kërkimeve thelbësore mbi toponiminë dhe mikrotoponiminë e vendbanimeve të lartëpërmendura. Nga ky studim do të mësojmë mbi kulturën dhe mënyrën e jetesës së banorëve të kësaj ane prej antikiteti e deri në ditët tona.

Një vështrim të theksuar do të hedhim mbi fenomenet fonetike dhe morfologjike të mikrotoponimet me prejardhje iliro-shqiptare dhe se cilat dukuri fonetike i hasim.

Studimet e fundit dialektore na mësojnë se ky areal shtrihet në arealin e gjashtë dialektor tek i cili mungon zanorja “y” që nënkupton se kemi të bëjmë me gjashtë zanore, dhe nëse kemi ndonjë mikrotoponim ku mund të hasim edhe zanoren “y”.

Hipotezat

Rajoni malor dhe vendbanimet që gravitojnë brenda shtrirjes së kufijve të administruara nga Komuna e Vrapçishtit, respektivisht vendbanimet: Gjurgjevisht, Llomnic, Kalisht, Gorjan. Konfiguracioni i relievit të këtij regjioni, na motivon për një hulumtim të mirfillt shkencor mbi thesarin e pazbuluar deri më tani të kësaj treve.

-Nga këndvështrimi gjuhësor e me theks të veçant mbi (toponimet dhe mikrotoponimet) prej ku do të duhet nxjerrim në dritë diçka më shumë se një punim magjistrature. Por, edhe mbi vlerat historike nga e kaluara, rreth vegetacionit gjuhësorë në këtë hapsirë shqipfolëse. Gjithashtu përmes emërtimeve të lëmive të ndryshme do të mund të konstatojmë më precizitet se cilat veprimtari ekonomike kanë qenë më të zhvilluara, më të përhapura në këto vendbanime në të kaluarën e deri në ditët tona.

-Për një studim të këtillë interesim të veçantë kanë zgjuar dukuritë e ndryshme fonetike që i hasim në të gjitha shtresat gjuhësore si nga substrati illiro-pellazg, ashtu dhe nga adstrati turko-sllav dukuri që janë ngjizur denjësisht në gjuhën shqipe dhe që janë përshtatur fonetikiisht me trajtat e gjuhës së kësaj ane.

-Karakteristikë e emërtimeve toponimike dhe mikrotoponimike e këtyre trevave është se do të hasim emërtime simotra nga një vendbanim tek tjetri e me radhë. Dukuri tjetër që zgjon interesim të veçantë është se gjatë kohës së mbretërisë SKS⁴, në disa fshatra nuk kanë mundur që t’i përkthejnë dhe kanë ngelur të paprekura dhe sot emërtimet e tilla tingëllojnë shqip.

⁴ Mbretëria Sërbo Kroate Sllovene

-Sqarimi i kësaj lëmije do të paraqitet përmes formës teorike apo edhe asaj në terren ku do të rezultojë mundësia e analizimit më të thellë të temës.

Metodologjia e hulumtimit

Fazat e kërkimit

Faza përgatitore

1. Studimi i literaturës.
2. Hartimi i pyetësorëve.
3. Formulimi i platformës studimore:

>> **Onomastika e fshatrat malore të Komunës së Vrapçishtit**<<

(Gjurgjevisht, Llomnic, Kalisht, Gorjan,)

Faza e mbledhjes të të dhënave

1. Pyetësorët me studentët, ekspeditat gjuhësore.
2. Intervistat e drejtpërdrejta.
3. Materialet leksiko-frazeologjike e folklorike në periodikë të kohës.
4. Materiale sociolinguistike, ndryshoret siç janë ata të gjinisë, moshës e besimit.
5. Krijimi i atlasit dialektologjik për dukurit të ndryshme të të dy të folmeve

Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

1. Përfaqja me studime të mëparshme, duke plotësuar analizën për një territor më të gjerë që përfshin mbi 20 pika të grumbullimit të të dhënave.
2. Analiza e veçorive fonetiko-gramatikore dhe shqyrtimi sociolinguistik i frazeologjisë, duke e parë në vështrim përfaqësues me punime të mëparshme në këtë fushë.
3. Shqyrtime të thelluara dhe mbështetëse për toponiminë e fshatrave të Gostivarit
4. Përgjithësime dhe përfundime.

Duke u nisur nga qëllimi i punimit, metodologjia e kërkimit u mbështet në shqyrtimin sinkronik dhe diakronik tek **Onomastika e fshatrat malore të Komunës së Vrapçishtit**

(Gjurgjevisht, Llomnic, Kalisht, Gorjan,) në përdorimin situativ të saj në kontekste të përcaktuara nga pjesëmarrësit në komunikim në vende dhe kohë të ndryshme duke ndjekur dy drejtime:

1. Së pari, mbledhja e materialit gjuhësor në terren sipas pyetësorit duke hulumtuar konkretisht përdorimin e tyre në bashkësinë shoqërore përkatëse. Për këtë u mbështetëm në pyetësorët e hartuar për mbledhjen e materialit dialektologjik, duke e shqyrtuar në aspektin fonetik, morfologjik dhe leksiko-frazeologjik të kësaj të folmeje.
2. Së dyti, shqyrtimi i materialit faktik mbi bazën e literaturës teorike për të të dhënë një pamje të plotë fonetiko-gramatikore, leksiko-frazeologjike, sociolinguistike dhe etnolinguistike të kësaj ane.

Rëndësia e punimit

E veçanta e këtij studimi qëndron tek natyra gjurmuese e lëndës të cilën e kemi për objekt studimi siç e kemi titulluar **”Onomastika e fshatrat malore të Komunës së Vrapçishtit” (Gjurgjevisht, Llomnic, Kalisht, Gorjan).**

Edhe në të kaluarën nga disa studiues janë bërë disa studime gjuhësore rreth këtij regjioni por, nuk kanë qenë të kesaj natyre, më së shumti u janë përkushtuar dukurive fonetike, me gjasë edhe folkloristike. Prandaj, duke parë një rrafsh më të gjërë studimi me karakter etnolinguistik, dëshirojmë që gjeneratave të ardhshme t'ju sjellim risi dhe t'u shërbejë si një gurëthemelë në studimet e tyre më të thelluara gjuhësore.

Mikrotoponimet si vlera gjuhësore nuk mund të konsiderohen thjeshtë vetëm si emirtime rasti, por çdo mikrotoponim ngërthen një histori më vete, dhe përçon një mesazh historik, ato janë bërthama e një gjuhe, ajo që është për arkeologjinë fosili, të njejtën baraspeshë mund të themi e ka mikrotoponimi.

Duke e ditur se vendbanimet malore nga vit në vit shkojnë drejt rrënies së numrit të banorëve për shkak të kushteve më të mira jetësore, apo edhe migrimit familjar nëpër shtetet perendimore, ky karakter studimi sa vjen e zbehet, ndoshta në një të ardhme edhe mund të harohen emërtimet toponimike dhe mikrotoponimike prandaj, ideja jonë është që përmes këtij punimi të ndërtojmë një mpërmendore të shkruar e cila do t'i ruaj të gjalla ndër shekuj këto margaritarë gjuhësorë që në vete ngërthejnë një histori të tërë të kësaj treve.

HYRJE

KOMUNA E VRAPÇISHTIT

Poziat gjeografike dhe historiku i komunës së Vrapçishtit

Komuna e Vrapçishtit shtrihet në pjesën lindore të Pollogut të Epërm, pjesa perendimore shtrihet në Malin Sharr, malë i cili në kondrinat e tij shtrihet disa vendbanime malore, fshatra të cilët janë objekt studimi siç janë: **Gjurgjevishti, Llomnica, Kalishti, Gorjani.**

Hapësirën tokësore që zë shtrirja e komunës në Fushëgropën e Pollogut të Epërm ka një rëndësi të veçantë, sepse nëpër territorin e kësaj komune kalon Autostrada “Nënë Teresa” që lidhë linjën që përbën arterien kryesore për qarkullim në trevat shqiptare të Republikës së Maqedonisë si: Shkup-Tetovë-Gostivar-Kërçovë-Ohër dhe Gostivar-Dibër.

Ne lindje të komunës kalon hekurudha Oher-Shkup, që lidh komunat me qendrat urbane. Rëndësi të veçantë ka autostrada perendimore e Pollogut, që është pjesë e Koridorit VIII. Dhe lidhë aksin rrugor Durres-Qafë Thanë-Shkup-Sofje-Stamboll. Përmes vendbanimeve në perëndim të rrugës Gostivar-Tetove, në të majtë të rrjedhës së Vardarit kalojnë rrugët lokale që lidhin fshatrat e kësaj komune midis tyre edhe në qendrat urbane. Territori i komunës shtrihet në pjesën veriperendimore të Maqedonisë, në një formë të përzgaturur veriperendim-lindje.

Largesia nga kryeqyteti është 63km dhe lidhet me të përmes tri rrugëve, njëra prej të cilave është autostrada. Komuna përfshin 15 vendbanime. Terësia e territorit shtrihet në drejtim lindje-perendim 17-19km gjatësi, kurse gjerësi 8-10km, pika më veriore e territorit me pikën me jugore shtrihet në distancë prej 7 km, ndërsa pika më perendimore me pikën më lindore shtrihet në distancë 19.6 km.

Komuna e Vrapçishtit, në lindje kufizohet me Malin e Thate, në jugperendim me Gostivarin. Kurse në lartësi të Sharrit, me kufirin shtetëror të Kosovës, në Veri me Komunën e Bogovinës Komuna shtrihet në një sipërfaqe prej 185.1 km² apo 0.76 % të sipërfaqes së përgjithshme të Republikës së Maqedonisë. Perendimore me pikën më lindore shtrihet në distancë 19.6 km Komuna e Vrapçishtit, në lindje kufizohet me Malin e Thatë, në Jugperendim me Gostivarin.

kurse në lartësi të Sharrit, me kufirin shtetëror të Kosovës, në veri me Komunën e Bogovinës Komuna shtrihet në një sipërfaqe prej 185.1 km² apo 0.76 % të sipërfaqes së përgjithshme të Republikës së Maqedonisë.

KUFIRI I KOMUNËS SË VRAPÇISHTIT



-Huazuar nga punimi i Temës së Diplomës nga prof. Nijar Vejseli, 2009, f.5

TAB.1. VENDBANIMET E KOMUNËS SË VRAPÇISHTIT SIPAS NDARJES SË RE

Lartësia mbidetare, sipërfaqja, popullsia dhe struktura e sipërfaqes së **K.Vrapçishtit**⁵

Komuna dhe vendbanimet	Lartësia mbidetare	Siperf. Territor Për km ²	Numri banorë Sipas viteve		Struktura agrare e territorit në hektarë (h ²)			
			1994	2002	Tokë pjellore	Kullota	Pyje	Gjithsejt
Komuna e Vrapçishtit	716	185.1	24.465	25.399	4.820	5.366	4.686	14.872
Vrapçisht	580	8.5	5.235	4.874	661	85	32	778
Vranjofcë	800	9.8	670	480	150	28	779	957
Gallatë	600	3.6	970	1.151	248	43	21	312
Gorjan	940	5.5	100	70	198	180	136	514
Gradeci	540	10.3	4.266	4.555	735	47	141	973
Dobridoll	570	6.4	4.199	5.233	459	14	111	584
Gjurgjevisht	1000	16.1	706	403	350	854	276	1.471
Zubofcë	600	4.0	554	762	330	17	25	372
Kalisht	840	220	873	681	247	832	1.107	2.186
Llomnicë	1030	27.0	796	574	203	1.773	678	2.654
Negotinë	575	8.0	3.331	3.673	584	110	23	717
Novosellë	600	1.7	21	19	42	0.8	120	163
Pozharan	920	29.4	58	26	318	1.362	1.176	2.856
Senakos	570	2.3	1.404	1.634	152	9	49	230
Toplicë	570	2.3	1.292	1.274	143	11	21	175

⁵ Grup autorësh: "Gostivarskiot kraj" Gostivar 1970 J.Trifunovski "Pollog", Beograd 1997, Fq. 11/12

Historiku i popullimit

Nga hulumtimet e mirëfillta shkencore është vërtetuar se autoktonia në Pollog u takon shqiptarëve si pasardhës të ilirëve. Gjithashtu, kjo gjë është e vlefshme edhe për Komunën e Vrapçishtit.

Burimet e shkruara të mesjetës së hershme dhe të mesme për popullsinë janë të pafavorshme dhe nuk kanë të bëjnë me komunitetet në veçanti, janë të varfëra. Shkrimet më të vjetra dhe më të afërta, komuna i ka në fshatin Gradec, ku behet fjalë për një lokalitet të shekullit I, në këtë mbishkrim varri është fytyra e gruas me shami në kokë, e gdhendur në gurë, kurse në një lokacion po të këtij vendbanimi, është gjetur një monedhë në të cilën është koka e Apollonit, e cila daton rreth shekullit të V. Me ardhjen e turqve në Ballkan, siç dihet një pjesë e popullsisë u islamizua. Defterët Osman dëshmojnë se popullsia në këtë vend ishte myslimane.

Sipas anketës në këtë komunë, janë vendosur dy familje turke. Kurse sot, me ndikimin e politikave sllave duke u përpjekur që të zvogëlojnë numrin e shqiptarëve, thuhet se janë turqizuar afro 40% e popullsisë së fshatit Vrapçisht.

Zvogëlimit të numrit të popullsisë shqiptare, i kanë sherbyer edhe masa të tilla si emigracioni ekonomik i shqiptarëve për në vendet e Evropës Perendimore, këto janë procese të cilat dëshmojnë për defektet e sistemit shtetërorë në Maqedoni, që u ka mohuar shqiptarëve statusin juridik dhe të drejtën si shtet-formues

Evolucioni i popullsisë Edhe në Komunën e Vrapçishtit, njelloj si në shumë komuna të tjera në vazhdimësi, sidomos, pas Luftes së Dytë Botërore, të dhënat për numrin e popullsisë shqiptare në ish-Jugosllavinë nuk kanë qenë aq përafersisht të sakta. Ekzistojnë të dhëna mes dy luftërave botërore, por që duhet marrë me rezervë. Te gjitha të dhënat lidhur me këtë, kanë qenë tendencioze dhe me prapavijë të errët politike. Më e pranueshme është që, numri i popullsisë së komunës të ndiqet pas Luftes së Dytë Botërore. Pas regjistrimit të popullsisë nga viti 2002 rezulton se në Komunën e Vrapçishtit jetojnë mbi 25.339 banorë, ku dendësia mesatare arrinë 142 banorë/km². Ndërsa në të gjithë Pollogun mesatarja arrinë 125 banorë/km².

KREU I

MIKROTOPONIMET SIPAS FSHATRAVE

FSHATI GJURGJEVISHT

Pozita gjeografike:

Gjurgjevishti është fshat tipik malor, i cili shtrihet në brigjet e Mali Sharr, ku lathtësia mbidetare arrin rreth 1000m. dhe me një largësi nga qyteti i Gostivarit prej 17 km. Fshati Gjurgjevisht në Lindje kufizohet me Gorjanin, në Perendim me fshatin Llomnic, në Jug me fshatin Negotinë e Pollogut dhe në bregun e lumit Mzdraça me fshatin Kalisht, kurse në Veri me Republikën e Kosovës.

Historiku i fshatit:

Duke u bazuar mbi gjurmët arkeologjike mendohet se ky vendbanim të jetë shumë i hershëm. Por si vendbanim e gjejmë të dokumentuar shumë vonë, edhe atë në arkivat turke emri i fshatit përmendet në dokumentet e vitit 1467-1468⁶

Sipas regjistrimeve të popullsisë nga viti 1545, ky vendbanim numëronte 36 familje ndërkaq sipas regjistrimeve të vitit 1568 fshati numëronte 34 familje të krishtera⁷. Në regjistrimet e gjysmës së dytë të shekullit XX kemi këto të dhëna sipas regjistrimeve të viteve si vijon:

1971-87 shtëpi-733 banorë; 1981-101 shtëpi 762 banorë. Dhe në regjistrimet e më vonë shme të shekullit XXI përkatësisht viti 2002 fshati numëronte 77-shtëpi dhe 403 banorë⁸.

Rreth etimologjisë së emrit të fshatit ka disa varieante dhe mendime por që nuk është vërtetuar akoma. Sipas albanologut Hasan Hoda i cili është i mendimit se ky ojkonim duhet të

⁶ Тур.Док.За ист. На мак.Нар.опш. поп.дефт.,N.4(1467-1468год.)Скопје, 1971. f, 116

⁷ По аты...

⁸ Librat e regjistrimit të vitit 1971-81 dhe 2002, Kuvendi I Komunës së Gostivarit- Enti shtetëror statistikori Republikës së Maqedonisë.

ketë etimologji ortodokse. Pra, sipas tij emri duhet të ketë për bazë një emër vetjak **Gjergj** dhe prapashtesën **-isht**⁹.

Sipas studiuesit dr.Qemal Murati¹⁰ i cili nga ky kontekst shpjegon se përdorimi i ermave etnik për shqiptarët në mesjetë, e sidomos emrat vetjakë, në bashkëvajtje me emra kryefamiljarësh, tek të cilët përmbahet ermi etnik Arbanas si element i parë(emri i të birit) apo i dyti (emri i të jatit), si element atributiv i përkatësisë etnike të nxjerrë nga defterët e regjistrimeve turko-osmane nga shek XV në këto anë p.sh. Gjura Arbanas/ fshati Leshnicë, Gjurash, i biri i arnautit/ fshati Reçicë, Gjorgji, i biri i Arbanasit/ fshati Zdunjë, janë elemente që na çojnë të mendojmë për prejardhjen e emrit të fshatit Gjurgjevisht¹¹.

Banorët e fshatit kryesisht janë mërgimtarë të cilët punojnë në vendet perendimore kryesisht në Itali dhe kohëve të fundit në Gjermani dhe Zvicër. Pjesa tjetër e mbetur në këtë vendbanim ekzistencën e sigurojnë nga blektoria dhe ndonjë të punësuar tek-tuk në punë shtetërore. Pjesa dërmuese janë të papunë.

Sa i përket ifrastrukturës që nga vitet e 90-ta të shekullit të kaluar, në fshat u instalua ujësjellësi i ri me kapacitet që i kënaqë nevojat e banorëve. Që nga vitit 1994 fshati posedon edhe shkollë fillore 9 vjeçare, poashtu u ndërtua edhe një ambulantë për nevojat e fshatit, ku edhe sot është në funksion dhe ka një mjek, që kujdeset për nevojat e fshatit.

Nga viti 2000 fshati posedon edhe rrjetë telefonik dhe internet, rruga është e asfaltuar 6.5 km deri ne Sanakos. Gjurgjevishti ka edhe objekte fetare si xhaminë e fshatit dhe një teqe. Xhamia e ndërtuar në vitin 1982 dhe e riparuar disa herë ku meremetimi i fundit u realizua në verën e vitit 2018. Fshati posedon dy shitore për nevojat e banorëve dhe dy kafene ku të rrinjtë e fshatit e kalojnë kohën e lirë. Banorët e fshatit të gjithë janë të nacionalitetit shqiptarë të besimit islam.

Fenomeni i shpërnguljes dhe migrimit drejt vendeve perendimore nuk e ka kursyer as këtë fshat kjo dukuri e ka bërë që ky vendbanim të lëngojë nga mungesa e rinisë, e nxënësve dhe e gjallërisë normale.

⁹ Hasan Hoda, vep.cit.f.15

¹⁰ Qemal Mrati, Shqiptarët dhe Ballkani ilirik..., Tetovë, 1999, f.50-51

¹¹ Izmit Durmishti.Vezhgime gjuhesore mbi toponimine dhe antroponime e Polloguit te Eperm te Gostivarit, f.49

Një pjesë e madhe e familjeve janë shpërngulur drejt fshatrave fushorë si: Debresh, Negotinë, Sanakos, Gradec e deri ne rrethinat e Tetovës dhe brenda qytetit.

Sot fshati figuron i ndarë në disa lagje si: Mëhalla e Epër, Mëhalla e Poshtme dhe Mëhalla e Mbas Lisave. Në lagjet e lartëshënuara jetojnë fiset e:

Kiceve,

Cakëve

Sharakatëve,

Partallëve,

Imerallarëve, etj.

Në këtë lokalitet figuron edhe teqeja e fshatit e rindërtuar në vitin 1990 por nuk dihet se prej kurë e ka ekzistencën ky objekt kulti.

Mikrotoponimet e fshatit Gjurgjevisht:

Arat: Arat e Pashës, Arat e Shpesha, Arat T^aur

Malet: Matene, Çestak, Vllaxhe, Prroj Thatë

Kodrat: Kodra e Dushkut, Kodra e Madhe, Kodra e Zabelit

Emra gropash: Gropa e Qenëve

Livadhet: Livadh i Sheh Begut, Livadhi i Madh, Livadhe të Çiklave, Livadhe të Gjata, Livadh i Kosmonit.

Mullinjtë: Mulliri i Emrës, Te Mullojt

Udhët: Udha e Lopëve

Emra urash:

Gurët: Guri Valavajcës, Guri Sharakatit, Guri Shqipës, Guri Zi, Guri Bithndujë, Guri Çanakit, Te Gurët e Bardhë, Guri Ukit, Guri Beshirit.

Drunjtë: Druri i Sejdës, Druni Qazimit

Kullosa: Kullosa e Hajdarit

Shpella:

Varret: Vorre Plaka, Vorre Shkijesh, Vorrët e Kalisit, Varret e Reja

Korija (Zabele): Në Zabel

Gropa: Gropa e qenvee, Gropa e Lejthis

Xhollët: Xhollët e Kolve, te Xhollët

Kep: Kepi i Shtarës, Tre Kepa, Kepi i Ibishit

Kodër: Kodra e Dushkit, Kodra e Madhe, Kodra e Zabelit

Lug: Në lugje, Në Lug të Selimit

Ledinë: Ledin Epër, Ledin e Poshtë

Maje: Mja e Minares

Rrafsh: Rrafsh të Kullës, Rrafsah të Linishtave, Rrafsh e Saufës, Rrafah e Gurit Zi, Rrafshtejna,

Rrah: Në Rraha,

Tumb: T^aum Vilivërfi

Vllag: Vllaxhe

Hidronime

Krojet: Kroj i Shehit, Kroj i Cakave, Kroj i Halimes, Kroj Halitit, Kroj Poshtë

Çeshme:

Uji: Uji i Tharët

Burim: Kajnaki i Madh, Kajnaçet e Milicëve,

Lumenjtë: Muzdafçe, (Mazdraça)

Emra moçalesh: Ligatat e Kicës, Ligata, Shavarë, Ligatë e Merës, Ligatat të Kullës.

Përenjtë: Përroj i Jezerit, Përroj i Dorjanit, Përroj i Matenës, Përroj i Thatë, Përroj halles Nishe, Përroi i Rrafshtejnave.

Gjoli: te Xholi në Shavar

Jezer: Jezeri i Zi,

Ligata: Ligatë e Merës, Në Ligata, Ligata të Kicës,

Llak: Llajk e Madhe, Llajk e Vogël

FITONIMET

Bgrem: Te Bagremat e Vorreve

Cer: Në Cer të Kalishtit

Dushk: Në Dushk të Saufës, Kodra e Dushkut

Dardh: Te Dardha,

Fier : Fejr i madh

Jasik: Jasejk e Hamitit

Plep: Plepat e Ficës

Lejthi: Në Lethi, Gropa e Lethis

Lipa: Në Lipa

Lisa: Mbas Lisa, Ndër Lisa,

Man: Te Moni

Kojri: Në Kujri

Ormon: Në Ormo

Zabel: Në Zbel, Kodra e Zabelit

Sokol:

Ujk: Guri Ukit

Arri: Kroi i Arrushës

Ornic: Ornic e Alis

Vneshë: Vneshët e Vjetra, te Vneshët

Argaç: Në Argaçe,

Govedar:

Xhibre: Xhibre Kurtishit, Xhibre Lopve

Kolibe: Kolibja te Kulla

Kep: Kepi Shtarës, Kepi Ibishit, Tre Kepat

2. gjeogr. Breg shkëmbor që zgjatet në det, hundë toke në det. Kepi i Rodonit. Kepi i Gjellbër.

Kodër: **KODËR** *f.* 1. Pjesë toke e ngritur si breg i lartë me pjerrësi të butë; mal i ulët nën një mijë metra dhe me shpate të buta. Kodër shkëmbore. Kodra me brezare (me vreshta). Rrëzë kodrës. Faqja e kodrës.

2. Pjesë e ngritur mbi një sipërfaqe të rrafshët. Dërrasë me kodra.

* Kodra pas bregut gjepura, dokrra. Flet (hidhet) kodër më kodër flet kuturu, pa lidhje e pa arsyetim. Të hedh kodër më kodër nuk tregon qartë e në mënyrë të përpiktë atë që duhet ose atë që i kërkohet (zakonisht për tëiu larguar çështjes kryesore); kalon nga një çështje në tjetrën pa i sqaruar. Ngre kodra përmbi det iron. përpiqet të bëjë punë që janë të pamundura të bëhen, bën kështjella në erë. Gjahu në breg e qëllon në kodër shih te GJAH,~U.

Kojri: **KUJRI** *f. hist.* 1. Pyll, kullotë, tokë a vend tjetër që shfrytëzohej bashkërisht nga gjithë katundi.

2. përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Tokë kujri.

Kolibe: **KOLIBE** *f.* 1. Kasolle e ndërtuar me thupra ose me dërrasa të vjetra dhe e mbuluar me kashtë, me copa dërrasash a me teneqe; kasolle e vogël dhe e keqe. I prishëm kolibet.

2. Kasolle e vogël për qenin.

Kroj: **KRUA** *m.* Burim uji, që në vendin ku del rregullohet e pajiset zakonisht me një lug, me një lëfynt ose me ndonjë mur të posaçëm; gurrë, burim, vendi ku del burimi; uji i tij. Krua i ftohtë. Kroj i fshatit. Ujë kroj. Mbush ujë në krua. Pi ujë në krua. Lahem në krua.

* Kemi pirë ujë në një krua jemi prej një vendi; jemi të afërt; e njohim mirë njëri-tjetrin. Ka pirë ujë në shumë kroje (burime) shih tek UJ/Ë, ~I. Të shpie (të çon) në njëqind (në dyzet) çezma (në krua, në shtatë kroje) e sëtë jep ujë të premton, të sjell rrotull dhe nuk të mbaron punë. Kroj (pusi) i mirë njihet në kobë të thatë fj.u. në rrethana të vështira njihet njeriu i mirë e i zoti ose miku i vërtetë.

Kullosa: KULLOSË *f.* Kullotë. **KULLOTË** *f.* 1. Vend me bar, ku çohen bagëtitë për të kullotur. Kullotë e mirë (e varfër). Kullotë delesh. Kullotë natyrore. Kullotë verore bjeshkë, mal. Kullotë dimërore vërrë.

Zgjerimi (përmirësimi) i kullotave.

2. Ushqim për bagëtinë ose për shpendët. E ka kullotën të mirë. U hedh bagëtime kullotë.

* E hëngri kullotën (barin, livadhin, çairin) shih te HA.

Kullë: KULLË *f.* 1. Shtëpi e lartë prej guri me dy a tri kate, e ndërtuar zakonisht në një vend të ngritur, me dritare të vogla dhe me frëngji, që shërbente si banesë dhe për mbrojtje; kali i dytë i një shtëpie të tillë me odat e miqve; shtëpi. Kullë e vjetër. Kullat e malësisë. Kulla e sanës ahuri i kashtës. Ngujoheshin (mbylleshin) në kullë.

2. arkit. Pjesë e ngritur mbi muret e një kalaje a të një ndërtese, e pajisur me frëngji që shërbente për vrojtim e për mbrojtje. Kullat e kalasë së Krujës. Vështronte nga kulla.

3. spec. Ndërtesë e vogël dhe e ngushtë, e ngritur në një vend të lartë, nga ku mund të vrojtohet larg ose të jepen urdhra e udhëzime; për të drejtuar një veprimtari.

Kullë vrojtimi. Kulla e komandimit. Vrojtoi nga kulla.

Lëdinë: LËNDINË *f.* 1. Tokë e lënë pa punuar, tokë djerr. Lëdinat e fshatit.

2. Shesh i vogël, i veshur me bar të njomë. Lëdinë malore. Lëdinë në mes të pyllit. Rrinte në lëdinë. Kullot bagëtia në lëdinë.

* E bëri lëdinë diçka e shkatërroi krejt, e bëri rrafsh me tokën, e bëri shesh.

Ia nxori (ia qiti) në lëdinë diçka ia nxori diçka që e mbante të fshehtë, ia nxori në shesh.

Lajthi: LAJTHI *f. bot.* Dru a shkurre e vendeve malore me klimë të butë ose e vendeve të ngrohta e me lagështi, me degë të holla e të lakueshme, me gjethe si zemër, të gjera e me dhëmbëza anash që bën kokrra të vogla me guaskë të fortë; kokrrat e kësaj bime, që kanë brenda një thelb të rrumbullakët a pak të zgjatur, i cili hahet. Lajthi e butë. Lajthi e egër. Lajthi të pjekura (të qëruara). Pyll me lajthi. Thyej (çaj) lajthi.

Ligata: LIGATINË *f.* Vend i lagësht e me bar, tokë që mban gjithnjë ujë; moçalishte. U bë ligatinë.

I kemi tharë ligatinat.

Lipa:

Lis: 1. bot. Dru pylli i lartë, me gjethe me dhëmbëza anash, që lidh lëndë dhe që përdoret si lëndë ndërtimi e për zjarr; dushk. Lis i bardhë qarri. Lis i butë bungëbuta.

Lis bujk bulgri. Lis i egër ashe. Dru (trung, lende) lisi.

2. Dru i lartë. Pyje me lisa të dendur. Sa më i gjatë është lisi, aq më shumë e zë era. fj. u.

3. etnogr. Tërësia e pasardhësve që rrjedhin nga një baba a nga një nënë.

Lisi i gjakut njerëzit që rrjedhin nga një baba. Lisi i gjinisë (i tamblit, i qumështit) njerëzit që rrjedhin nga një nënë.

Livadhet: **LIVADH** *m.* Fushë a shesh i madh me bar, pa drurë e shkurre. Livadhet malore. Livadh me lule.

Tërfile i livadheve. bot. Trumcaku i livadheve. zool. E la livadh. Kositin livadhet.

Lëshoi bagëtinë në livadh. Kullotin në livadh.

* U bë livadh tall. piu shumë, u bë tapë. E bëri livadh diçka e zbukuroi shumë, e bëri fushë me lule. E hëngri livadhin (çairin, barin, kullotën) shih te HA. Ia bëri mendjen livadh dikujt ia prishi mendjen, ia mori mendtë, e hutoi. Hyri në livadh të huaj hyri në një punë që sëi takonte; shkeli të drejtat e një tjetri. Sëkorret livadhi me gërshtë fj. u. sëbëhet një punë pa pasur mjetet e nevojshme. Thur livadhin e lë shtegun hapur shih te THUR.

Llakë: **LLAKË** *f.* Gropë a pellg me ujë, zakonisht në mal, ku pinë bagëtitë; pellg me ujë të ndenjtur.

Llakë bore. Llakë me ujë shiu.

Lug: **LUG** *m.* 1. Copë e gjatë druri a guri, e gërryer dhe e bërë si govatë për tëu dhënë ujë a ushqim kafshëve; koritë; mjet i tillë që përdoret për të mbajtur a për të përpunuar diçka. Lug i gurtë (i drunjtë). Lug guri (druri). Lugu i bagëtive (i derrave, i pulave). Lug rrushi.

2. Ulluk prej druri, prej teneqeje etj. nëpër të cilin rrjedhin ujërat. Lug druri (dërrase, llamarine).

Lugu i kroit (i çezmës). Lugu i mullirit (i dërstilës). Lugu i ujit. Lug për të ujitur arat.

3. E thelluar për së gjati në një dru ose në një gur; hapësirë a vrimë e madhe për së gjati një sendi, nëpër të cilën kalon diçka. Lugu i oxhakut. I bëri një lug.

4. Pjesa e thelluar për së gjati qafës ose boshtit të kurrizit te njeriu; e thelluar a gropë në një pjesë të trupit. Lugu i qafës (i shpinës, i kurrizit). Lugu i gjoksit.

Lugu i dorës (i këmbës). Lugu i zemrës grupa e vogël që është ndërmjet barkut dhe kraharorit.

Luginë e vogël, nëpër të cilën zakonisht kalon një rrjedhë uji, lugore; luginë. Lugjet e Verdha. top. Kulloste bagëtitë nëpër lugje.

5. Pjesë e ulët në një livadh, në një arë etj., që duket si hulli; shteg në borë që është rrahur nga të ecurit. Lugu i arës (i livadhit). Lugu i borës.

* U bë lug u palos me dysh (nga dhimbjet etj.). I kanë rënë gurë në lug i kanë dalë pengesa a ngatërresa në punë, i janë shtuar vështirësitë. I doli djersa në lug u lodh shumë, u raskapit.

Lumejtë: **LUMË** *m.* 1. Rrjedhë natyrore e madhe dhe e përhershme uji të ëmbël, që del nga një burim, shkon nëpër një shtrat në mes brigjesh dhe derdhet në det, në liqen ose në një rrjedhë tjetër më të madhe. Lumë i madh (i gjerë, i gjatë, i thellë). Lumë malor (fushor). Lumë i

lundrueshëm. Lumë i nëndheshëm (nëntokësor). Lumi i Shkumbinit (i Matit, i Semanit). Lumenjtë e Shqipërisë. Detet dhe lumenjtë. Ujë lumi. Shtrati i lumit. Brigjet (bërrylat) e lumit. Zalli i lumit. Vau i lumit. Burimi i lumit. Grykëderdhja e lumit. Degët e lumit. Gurë lumi. Peshk lumi. Urë mbi lumë. Në buzë të lumit. Në të dy anët e lumit. Matanë (përtej) lumit. Shfrytëzimi i lumenjve. Doli lumi nga shtrati vërshoi. U fry (ra) lumi. Lahen në lumë. U mbyt në lumë. Kaloi lumin. Lumi i Vjosës derdhet në detin Adriatik.

2. fig. Rrjedhë e madhe e diçkaje të lëngshme, që shkon me shumicë e pa pushim. Lumë gjaku. Lumë djerse. Lumë lotësh.

Maje: MAJË *f.* 1. Skaji më i hollë dhe i mprehtë i diçkaje, pjesa e diçkaje që vjen si thumb.

Maja e shpatës (e thikës, e bajonetës, e gjilpërës, e turjelës). Maja e gozhdës.

Maja e hostenit (e hurit, e shkopit). Majë pene pjesa e metaltë e penës për të shkruar. E bëj me majë diçka e mpreh. I bëj majën lapsit e mpreh që të shkruajë.

2. Pjesa e fundit e diçkaje, që vjen e zgjatur dhe më e hollë a më e ngushtë; skaji i fundit të diçkaje. Maja e gishtit. Maja e hundës. Maja e gjuhës. Këpucë me maja.

Gur me majë. Eci në majë të gishtërinjve.

3. Pjesa më e lartë e një mali, e një druri, e një trupi etj., që vjen më e ngushtë nga pjesa tjetër; pjesa e sipërme e diçkaje. Maja e malit (e kodrës).

Maja e kullës (e çatisë). Maja e pemës (e mullarit). Maja e kësulës. Maja e kokës çaçka e kokës. Hipi (u ngjit) në majë. Pa hipur në majë nuk mund të shohësh luginën

Malet: MAL *m.* 1. Vend shumë i ngritur mbi sipërfaqen e tokës që ka përreth, më i lartë se kodra, me majë a me kreshtë dhe me shpatë zakonisht të pjerrëta, që zbresin në lugina. Mal i lartë (i madh). Mal i veshur (i zhveshur, i thatë). Mal shkëmbor. Mali i Tomorit

(i Korabit, i Dajtit). Malet e Shqipërisë. Majë (kreshtë, shpat, faqe, brinjë, qafë, grykë) mali.

Rrëza e malit. Rrugë mali. Çaj mali shih te ÇAJ, ~I 1. Lule mali. Lëpjetë mali. Shpend mali. Erë mali. Vargu i maleve. Arë (kullotë) në mal. Fshatrat rrëzë (prapa) malit. Doli në mal. bised. doli partizan. Mori malet doli në mal, u arratis. Buçasin (gjëmojnë) malet. Iu ngjitën (iu qepën) malit. Zbresin nga mali. Rrofsh (të paçim) sa malet! ur. U mbushën malet me borë. Mali me malin nuk piqet, njeriu me njeriun piqet. fj. u.

2. bised. Krahinë malore, malësi; vendbanim malor. Mali ka klimë më të mirë.

Zbriti nga mali në qytet.

Man: MAN *m. bot.* Pemë me kurorë të gjerë, me gjethe si zemër e të dhëmbëzuara, që lidh kokrra të përbëra prej kokrrizash të lëngshme e të ëmbla, në ngjyrë të bardhë, të kuqe a të zezë; kokrrat e kësaj peme, të cilat hahen ose përdoren për të bërë raki, pekmez etj. Man i bardhë (i kuq, i zi, larush). Mana të ëmbla. Raki mani. Pekmez manash.

Shkund manin. Krimbat e mëndafshit ushqehen me gjethe mani. Pritëm për mana e na dolën thana. fj. u.

* E shkund manin në prill shih te SHKUND. Mana toke bot. luleshtrydhet, dredhëzat.

Moçal: **MOÇAL** *m.1.* Vend a fushë me ujë të ndenjtur e me baltë; ligatë, ligatinë, çeptirë. Moçale të ulëta (të larta). gjeogr. Moçal i keq (i qelbur). Ujë të moçalit. Erë moçali. Bimë (kashtë) moçali. Peshk moçali. Ethet e moçalit. bised. sëmundja e malaries. Tharja e moçaleve. Ngeci në moçal.

2. fig. Gjendje e rëndë, që karakterizohet zakonisht nga amullia, nga diçka e ndyrë, prapanike e konservatore etj. Moçali kapitalist. Moçali mikroborgjez.

3. veter., bised. Sëmundja e këlbazës. U binte moçali dhenve.

Mulli: **MULLI** *m.1.* Makinë e thjeshtë për të bluar drithë, që përbëhet nga pajisje të ndryshme, si edhe nga dy gurë të mëdhenj, të sheshtë e të rrumbullakët, të vënë njëri mbi tjetrin, nga të cilët i sipërmi lëviz me anë të fuqisë së ujit, të erës a me motor; ndërtesa me një makinë të tillë ku bluhet drithi. Mulli drithi. Mulli me ujë (me erë, me motor). Dishta (mokra, çakallja, gryka, penda) e mullirit. Koshi i mullirit. Gurët (mokrat) e mullirit. E bloi në mulli. Shkoi në mulli.

2. Makinë e posaçme me pajisjet e nevojshme, që shërben për të shtypur, për të thërrmuar a për të bluar diçka (gurë, ullinj etj.). Mulli vaji mulli ku shtypen ullinj të nxirret vaj. Mulli mineralesh. Mulli me çekiç për bluarjen e ushqimeve të ashpra (për shtypjen e qymyrgurit). Çekanët e mullirit.

Ormon: **ormani.m** (turq. Pylli i madh e i shpeshtë)

Ornic: (sllav. Ornica tokë e lëvruar)

Oronime: Një numër i konsiderueshëm vendesh duke pasur parasysh terrenin e përthyer të tyre, e kanë marrë edhe emrin sipas formës pozicionit dhe konfiguracionit të tyre. (Kryeziu 2000:146). Zakonisht kemi emra arash, kodrash, gropash, lugjesh etj.

Përroj: **PËRRUA** *m.1.* Rrjedhë uji më e vogël se lumi, që zbret nga malet, zakonisht me rrëmbim dhe derdhet në një lumë a në një liqen; shtrati i kësaj rrjedhe, me ujë a pa ujë. Përrua i rrëmbyer. Përrua i thellë. Përrua i thatë përrua që ka ujë zakonisht vetëm kur bie shi. Shtrati i përroit. Vërshimi i përrenjve në pranverë. Kaluan nëpër një përrua.

2. fig. Sasi e madhe e diçkaje; diçka që vjen me shumicë e me rrëmbim. Përrua gjaku. Përrenj fjalësh. libr. Një përrua njerëzish.

* Lumë a përrua shih te LUM/Ë, ~I. E hodhi përruan (lumin, vaun, hendekun) shih te HEDH 2. Zuri përruan (ledhin) keq. shih te ZË. Iu bë gjol e përrua shih te GJOL, ~I.

Plep: **PLEP** *m.1.* bot. Dru i lartë i familjes së shelgjeve, me trung të drejtë e me degë të holla të shtrira përpjetë, me gjethe në trajtë zemre, që rritet shpejt në vende me lagështirë dhe që ka lëndë të përshtatshme për ndërtim, për orendi shtëpiake, për prodhimin e letrës etj. Plep i bardhë plep deri në 35 metra i lartë, me lëvore në ngjyrë hiri të çelur, të lëmuar e të ndritshme, me gjethe me

push të bardhë në faqen e poshtme. Plep i butë plep i zakonshëm, me trung të hollë e të gjatë, që rritet në fushat e vendit tonë. Plep i egër plep deri 10-15 metra i lartë, me kurorë të rregullt, me lëvore ngjyrë hiri, me gjethe vezake të dhëmbëzuara, me bisht të gjatë e pa push, që rritet zakonisht buzë përrrenjve, në shpate malesh etj. Plep kavak plep i butë. Plep kanadez plep me kurorë të gjerë. Plep i zi lloj plepi deri në 25 metra i lartë, me lëvore ngjyrë hiri në të murrme. Dru plepi. Gjethe plepi. Dërrasë plepi. Pyll plepash. Mbjellin plepa. Është si plep ka shtat të lartë e të drejtë. U bëftë sa një plep!

Rrafsh: RRAFSH *m.1.* Sipërfaqe e diçkaje pa të ngritura e pa të thelluara. Rrafsh i lëmuar. Rrafshi i ujit.

2. Vend i sheshtë, fushë; krahinë pa male e pa kodra të larta. Rrafshi i Dukagjinit. Zbritën në rrafsh. i kthyen kodrat në rrafsh. i zuri këmba rrafsh zbriti në fushë; zbriti në vend të sheshtë.
3. gjeom. Sipërfaqe me dy përmasa, në të cilën një drejtëz që bashkon dy pika çfarëdo të saj ndodhet gjithnjë brenda saj; plan. Rrafsh paralele. Rrafshi i mesditësit. Kubi ka gjashtë rrafsh.

Rrah: RRAH *m.1.* Tokë buke a kullotë, që hapet në pyll duke prerë drurët e shkurret ose duke i djegur. Rrah në mes të pyllit. Rrah në mal. Hapën (çelën) rrahe. U bë rrah.
2. përd. ndajf. Shtrirë (për tokë, në shtrat). U rrëzua rrah përdhe. Ishin të gjithë rrah nga gripi.

Shpella: SHPELLË *f.1.* Zgavër e madhe natyrore brenda një mali a një shkëmbi. Shpellë e madhe (e thellë, e errët). Hyrja e shpellës. Njeriu i shpellave. Rronin nëpër shpella. U futën në një shpellë. Fshiheshin shpellave. E ka gojën sa një shpellë.

2. Gur i madh, shkëmb. E zuri një shpellë nën vete. Hipi mbi një shpellë.

3. përd. mb. bised. Shumë i fortë e i lartë (për zërin); fig. i fortë, shkëmb. E ka zërin shpellë. E ka kokën shpellë.

* Është shpellë e madhe është ngatërrestar i madh. Iu bë zemra shpellë u hidhërua shumë, u pikëllua nga një fatkeqësi shumë e madhe.

Shtrunga: SHTRUNGË *f.1.* Shteg i ngushtë afër derës së vathës, i bërë me gurë ose me gardh, ku shkojnë dhentë a dhitë një nga një kur i mjelim; vend i rrethuar në vathë ku futen dhentë a dhitë dhe prej andej nxirren një nga një nëpër një shteg të ngushtë për tëi mjelë. Shtrunga e vathës. Dera e shtrungës. Gurët e shtrungës. Ngre shtrungën. Mjel dhentë (dhitë) në shtrungë. Mbledh (fut) dhentë në shtrungë.

2. Vathë.

Sokol: SOKOL *m.1.* zool. Shpend grabitqar me sqep të kthyer dhe me krahë e thonj të fuqishëm; petrit. Sokoli kthetrazi. Hidhet si sokol.

2. fig. Djalë a burrë, zakonisht shtathedhur, trim e i zoti, petrit. Sokol mali. Sokol me fletë. Sokolat e brigadës (e batalionit). Sokoli i nënës! përk.

Stan: STAN *m.1.* Vend me vathë e me kasolle për bagëtitë, për barinjte e për bulmetin, i ngritur në mal për verë ose në vërrin për dimër. Stan veror (dimëror). Stani në mat (në bjeshkë). Stanet e kooperativës. Barinjte e stanit. Bulmeti i stanit. Qen stani qen i madh për të ruajtur bagëtitë.

Ngritën një stan. I çuan bagëtitë në stan.

2. Tufa e dhenve; kope, grigjë.

Teqe: TEQE *f.*1. Ndërtesë e veçantë për dervishët bektashinj ose për shehun, si edhe për ceremonitë fetare të një tarikati; manastiri a kuvendi i dervishëve bektashinj (në vendet ku vepron bektashizmi). Teqe e vjetër. Babai i teqesë i pari i një teqeje. Ishte pasuri (prone, tokë) e teqesë.

Hëngri (fjeti) në teqe.

2. fig. vjet. Vend i shenjtë.

Tumb: TUMBË *f.*Majë e zhveshur e një mali ose e një kodre; maja më e lartë e një mali ose e një kodre; vend i ngritur si kodër, breg, sukë. Tumbë rëre. Tumbë e mbuluar me bar. U ngjit në tumbë. Vështronte nga tumba.

Udhët: UDHË *f.*1. Brez ose rrip toke i rrahur a i shtruar për të kaluar njerëzit dhe mjetet; vija në ajër ose në det, nëpër të cilën kalojnë mjetet e fluturimit a të lundrimit; rrugë. Udhë e gjatë (e shkurtër).

Udhë e ngushtë (e gjerë). Udhë e drejtë (e shtrembër).

Udhë e shtruar (e pashtuar). Udhë malore (fushore). Udhë e rrahur (parratur).

Udhë e përpjetë (e tatëpjetë, e teposhtë). Udhë e madhe xhade. Udhë automobilistike.

Ujk: UJK *I m.*1. zool. Kafshë e egër mishngrënëse, e ngjashme me qenin, me qime të përhime në të verdheme, me veshë të drejtë e me majë, që sulmon shpesh bagëtitë. Ujk i murrmë (i kuqërremë). Ujk i madh. Ujk i uritur. Kope (lukuni) ujqish. Këlysh ujku. Lëkurë ujku. Strofull e ujkut. Angullima e ujkut. Të çaftë (të preftë) ujkut! mallk. Delen (dhinë) që ndahet nga tufa, e ha ujkun. fj. u. Ujku mjegull do. fj. u. Kur thonë «ngordhi ujkun», atëherë ruaje gomarin. fj. u. Qeni i keq e sjell ujkun në vathë. fj. u. Nuk fle (nuk kullot) delja me ujkun bashkë. fj. u. Ujku bari sëbëhet.

Varre: VARR *m.*1. Gropë e gjatë e gërmuar në tokë për të futur trupin e të vdekurit; vendi ku varroset dikush bashkë me grumbullin e dheut që i hidhet përsipër ose me muret e mbulesën. Varre të vjetra. Varre ilire. Varr i përbashkët gropë e madhe ku janë varrosur disa njerëz. Varr mermeri. Varret e dëshmorëve. Varr i gjyshit. Varr i një të panjohuri. Varret e fshatit varrezat. Pllaka (rrasa) e varrit. Guri i varrit. Hapi një varr. E futën (e shtinë) në varr. Vendosën kurora mbi varr.

Ia ka mbuluar varrin bari ka kohë që ka vdekur.

2. fig. Vendi ku gjen vdekjen ose shkatërrohet dikush, vendi ku merr fund dikush a diçka.

Pushtuesit këtu kanë gjetur varrin.

Vllag: **VLLAJË** *f.* Lehe. Vllajë farishtesh (duhani). Vllajë me lule (me trëndafila, me barishte). Mbjell në vllajë. Ujit me vllaja.

* Doli prej vllajës e ra në prush ra në një gjendje më të vështirë, ra më keq, iku nga shiu e ra në breshër.

Vneshë: **VRESHT** *m.* Toka e mbjellë me hardhi. Vresht i ri. Vresht i mirë. Rrush vreshti. Kërmilli i vreshtave. zool. Punojnë (plehërojnë) vreshtat. Prenë vreshtin. Spërkatën vreshtat. Sëbëhet vreshti me urata, po me shata e lopata. *fj.u.*

* Si lepur në vresht shih te **LEPUR**,~I. Flet në arë e në vresht shih tek **AR/Ë**,~A. Shkoi (u vra) si qenë në vresht (në rrush) shih te **QEN**,~I. Hajde baba të të tregoj vreshtin (arat)! iron. shih **BABA**,~I. Lule vreshti bot. dorëzonjë, lulevreshtë.

Xhibre: (sllav. Gjubre, pleh), xhibret e kolëve. Vend ku kanë ndejt bagëtia dhe e kanë plehëruar

Xhollët: **GJOLLË** *f.* Rrasë ku vihet kripa për ta ngrënë bagëtia; vend i thatë e gurishtë, ku shpien zakonisht bagëtinë për tëi dhënë kripë. Lëpin delja gjollën. Çoj dhentë në gjollë.

* Si dhia në gjollë nuk shköputet nga diçka që i pëlqen, ngulet diku me kënaqësi e nuk largohet.

Zabel: **ZABEL** *m.* Pyll i vogël e i dendur a pjesë pylli e ndarë me vete, koriye; vend me drurë e me shkurre të dendura. Zabel i dendur (i rralluar, i ripërtërirë). Zabel me dushk. Në mes të zabelit. U fut në zabel.

Zoonime: toponime që lidhen me emra të kafshëve

Përfundime

Punimi “Onomastika e fshatrave malore të Komunës së Vrapçishtit (Gjurgjevisht, Llomnic, Kalisht, Gorjan)”. Përfshinë një numër të konsiderueshëm *mikrotoponimesh* nga kjo trevë e cila shtrihet mbi sukate e Malit Sharr, dhe që gravitojnë brenda territorit të Komunës së Vrapçishtit. Rezultatet tona ishin të pritshme por deridiku edhe befasese nga këndvështrimi pozitiv.

Studimi është kryer në terren pra një studim empirik përmes pyetësorëve. Duke hulumtuar për secilin vendbanim në veçanti, puna jonë është shtrirë në të gjitha fushat si: Bujqësi, blektori, pylltari, xehetari, kulturë, hidronimi, antroponimi, zoonimi të cilat i kemi studiuar dhe klasifikuar në mënyrë të vraçant për secilin fshat.

Mbledhja dhe radhitja e të dhënave prej vendbanimeve nga ku i merrnim ka qenë detyra më e rëndësishme për ne, me qëllim që ky punim të jetë sa më afër origjinales. Mbase mundet që pa ndonjë qëllim të jetë bërë ndonjë lëshim ivogël për vendbanimet përkatëse. Por, askush nuk është i përkryer as edhe ne, kjo do të mbetet barë e gjeneratave të ardhshme gjë do të ecin drejt gjurmëve tona.

Qëllimi parësorë i yni ka qenë që të hedhim një hap, një shkëndijë drite, drejt zbardhjes dhe nxerrjes në pah të një etnie, të një kulture, të një treve që rri e heshtur prej shekujsh. “Gjuha ruhet aty ku shkruhet”(populli). Duke qenë të vetëdijshëm se kjo trevë nga aspekti shkencorë aspak nuk është e shfletuar, prandaj e plotë gojë vlersojmë se këtu kemi të bëjmë me një thesarë shumë të çmueshëm në rrafshin etnik.

Pse zgjodhëm mikrotoponimet e këtyre vendbanimeve si objekt studimi? Ashtu si edhe shumë vendbanimeve tjera që shtrihen në këto hapsira shqiptare, dhe vetë gjuha shqipe si e tillë është shumë vonë e dokumentuar, pra edhe kjo trevë ka ngecje e mangësi në këtë drejtim. Prandaj, për objekt studimi zgjodhëm mikrotoponimet e kësaj treve sepse gjetja e një mikrotoponimi për gjuhëtarin ka barasvlerën e gjetjes së një fosili për arkeologun.

Të bindur se në këto anë do të gjejmë gjurmë të një etnie shumë të vjetër bile edhe më te vjetër se sa mendonim ne. Toponime dhe mikrotoponime të shtresimeve gjuhësore të vjetra që vërtetohet se origjina e tyre rjedh nga substrati iliro-pellazg, gjë që demanton të gjitha teoritë pseudoshkencore, ku thuhet se shqiptarët e kësaj ane datojnë nga shek. XVII dhe XVIII.

Përsa i përket origjinës së këtyre fshatrave, fare lehtë vijmë në përfundim se janë shumë më të vjetër se sa mendohet. Bazuar në defterët turq të të shek XV respektivisht vitin 1467/68 të gjithë fshatrat kanë ekzistuar dhe thuhet se kanë qenë të krishtera. Argumente tjera të gjalla janë edhe varrezat e fshatrave, secili fshat ka mbi tri palë varreza. Duke filluar nga më te vjetrit të varrosura me rite pagane, pastaj të krishtera dhe më të rejat muslimane. Si relief malor ku shtrihen këto fshatra mbi 80% mikrotoponimet i kemi me prejardhje iliro-shqiptare. Pastaj ndiqen

nga ato turke e më pak sllave. Nga ku dëshmohej se kjo trevë gjithmonë ka qenë e banuar prej shqiptarëve nga ku dëshmohej autoktonia e tyre.

Mbi onomastikën shqipare është shprehur edhe profesor Eqrem Çabej i cili thekson se:

“Përsa i përket vendit tonë, unë prej shumë vjetësh kam formuar bindjen që toponomastika shqiptare përbën mbase dokumentin kryesor që vërteton autoktonin e popullit shqiptar në vendbanimin e tij të sotëm, d.m.th faktin që shqiptarët janë vendas në këto anë, që nga kohët më të lashta të historisë, pa ndërprerje”²⁵

Në bazë të këtij mendimi të profesor Eqrem Çabej mund të kokludojmë se *toponomastika*, po përgjithësisht *onomastika* ka rëndësi të madhe për të dhënat që ofron për popujt e moçëm të siujdhesës ilire ose Ballkanike.

Pas hulumtimeve të shumta në terren nga informatorë të ndryshëm, nga takimet dhe bisedat me nbanorë të kësaj treve, pas gjithë kësaj përmbledhje erritëm që me punën tonë të palodhëshme të sigurojmë një numër të konsiderueshëm të njësive toponomastike duke përfshi: oronime, hidronime, fitonime, zoonime etj.

Sipas numrit më të madh të mikrotoponimeve të gjetura duke i radhitur nga prejardhja dhe lloi që përcaktojnë numër më të madh përfshijnë mikrotoponimet shqip me mbi 221 njësi toponimike, pastaj ato sllave prej 19 njësi toponimike, duke u pasuar nga ato turke prej rreth 15, të përziera kemi 23 njësi toponimeke dhe të tjera 18 njësi toponimike d.m.th gjithnsejt kemi rreth 296 njësi toponimike. Pra edhe njëher këta numra dokumentojnë vazhdimësinë e pamohueshme dhe autoktoninë e shqiptarëve në këtë anë.

Ky material shpresojmë që t’u shërbejë gjeneratave të ardhshme si gurëthemel që ata me punën e tyre ta vazhdojnë dhe ta ndërtojnë kalanë.

²⁵ Dr. E. Çabej, Studime gjuhësore, V, Prishtinë, 1997, f.217

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Çabej, E. Studime Gjuhësore. Prishtinë, 1997

Doçi, R. ONOMASTIKA ILIRE-SHQIPTARE NË BALLKAN, Prishtinë, 2006

Durmishi, I. VËSHGIME GJUHËSORE MBI TOPONIMINË E POLLOGUT TË EPËRM,
Gostivar 2008

Shkurtaj, Gj. Onomastik dhe Etnolinguistikë, Tiranë, 2001

Kadriu, Z. Dialektet dhe të folmet e shqiptarëve në Maqedoni, Tetovë, 2002

Kadriu, S. Leksiku toponimik dhe patronimik i rajonit të Kumanovës, Kumanovë, 2004

Hoda, H. Negotina me rrethinë Tetovë 1995

Thomaj, J. Leksikologjia e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1978

Murati, Q. Dëshmime onomastike për autoktoninë e shqiptarëve në trojet etnike të tyre në
Maqedoni, Tiranë, 1993

Ismajli, R. Disa çështje të onomastikës shqiptare të Mesjetës, Studime filologjike, nr 4, Tiranë
1978

Studime gjuhësore I, (Dialektologji). Prishtinë, 1978

Studime gjuhësore II, (Dialektologji). Prishtinë, 1989

Hoxha, Sh. Gjurmime toponimike, Tiranë, 1998

Mirdita, Z. Antroponimia e Dardanisë në kohën romake, Prishtinë, 1981

Memushaj, R. Нурје нѐ Гjuhѐси, Tiranë 2002

Јован Трифуноски. Албанско становништво у Македонији, Београд, 1988

Јован Ф Трифуноски, Полог Антропогеографска проучавања, Београд, 1976

Selmani, A. Gjeografia e Maqedonisë Antike, Kumanovë, 2000

Beci, B. Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre, Tiranë, 2002

Ahmetaj, M. Gjurmime Onomastike, Prishtinë, Instituti Albanologjik, 2009

Ajeti, I. Kërkime gjuhësore, Prishtinë, 1978

Ibrahimi, M. Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të rrethit të Prilepit, Krushevës dhe Velesit, Shkup 2010

Halimi, M. Vështrime gjuhësore IAP, 1993

Ibrahimi, M. Tema sociolinguistike dhe etnolinguistike, Shkup 2012

Murati, Q. Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë, Tetovë, 2008

Shkurtaj, Gj. Onomastikë dhe etnolinguistikë, Tiranë, 2001

Rexha, I. Vendbanimet dhe popullsia albane e Kosovës (sipas defterëve osman të shekullit XV), Prishtinë, 2016

Biçoku, K. TOPONIMET MESJETARE PËR STUDIMET E HISTORISË SË SKËNDERBEUT, Tiranë, 2016

FGJSH. Tiranë, 2006

Informatorët

Fshati Gjurgjevisht

1. Rufat Bekteshi i lindur më 1979 Arsimit të lartë, i punësuar në MBP
2. Hazis Ismaili i lindur më 1955 Arsimit fillor, profesioni blektor
3. Pajtim Imeri i lindur më 1980 Arsimit fillor, profesioni blektor
4. Hazir Uzeiri i lindur më 1967 Arsimit fillor, profesioni tregtar

Fshati Llomnicë

1. Tosun Ismaili i lindur 1967 Arsimit fillor, mërgimtar
2. Safet Faruki i lindur 1972 Arsimit fillor, profesioni mjeshtrë ndërtimi
3. Nexhat Fetahu i lindur 1962 Arsimit të lartë, profesioni arsimtar
4. Irmija Ismaili i lindur 1963 Arsimit fillor, mërgimtar

Fshati Kalisht

1. Riza Nazifi i lindur 1954 Arsimit fillor, tregtar
2. Gzmond Memedi i lindur 1980 Arsimit të lartë, arsimtar
3. Nebi Kmberi i lindur 1970, arsim fillor mërgimtar
4. Imer Maliki i lindur 1974, arsim i mesëm, nënpunës shtetëror

Fshati Gorjan

1. Shaban Hetemi i lindur 1963 arsim fillor, tregëtar
2. Sulejman Mehdiu i lindur 1972, arsim fillor, mjeshtër ndërtimi
3. Ibrahim Veliu i lindur 1975, arsim fillor, mërgimtar
4. Enver Veliu i lindur 1960, Arsim fillor, mërgimtar

PËRMBLEDHJE

Onomastika si degë e rëndësishme e leksikologjisë për mua gjithmonë ka zgjuar një interesim të veçantë, gjithnjë duke dashur të mësojë më shumë mbi kuptimin dhe prejardhjen e emrave të përveçëm si: emra vetjakë, nofka apo pseudonime (antroponime). Dhe emrat familjarë apo edhe mbiemra që i quajmë (patronime).

Pas gjetjes së çdo njësie toponimike jemi përpjekur që t'i klasifikojmë nëpër familje fjalësh si: hidronime, oronime, fitonime, zoonime, metale, objekte kulti, komunikacion etj. Secili mikrotoponim ka rëndësi të vacant në konglomeratin tonë gjuhësor. Onomastika për çdo gjuhë përbën një lëndë të vlevshme e cila mund të plotësojë në një masë të madhe mungesën e dokumenteve të shkruara, si një arkiv gojor i historisë dhe lashtësisë së çdo shoqërie.

Që nga koha e studimeve të mia fusha onomastike e ka mbajtur të ndezur vazhdimisht kureshtjen time për t'u thelluar sa më shumë brenda një territori relativisht të hulumtuar nga këndvështrimet gjuhësore. Kjo dukuri na zgjonte edhe më shumë interesim për tu futur në botën e zbulimit të thesarrit gjuhësor.

Rëndësia e mikrotoponimeve për lëndën e gjuhësisë paraqet po aq interesim sa zbulimi i fosileve për arkeologjinë. Ambiciet tona në këtë fushë ishin të shfrenuara, kur e dinim se kemi të bëjmë me një hapsirë të pashkelur më parë ngase nuk ishin bërë më parë hulumtime të kësaj natyre. Praktikimi i metodës empirike në terren dhe mbledhja e të dhënave përmes pyetësorëve e bën më të vaçant punën tonë.

Fshatrat: Gjurgjevisht, Llomnicë, Kalisht dhe Gorjan i kemi vizituar dhe kemi kontaktuar me informatore të shumtë që jetojnë në këto hapsira. Pastaj materialin e mledhur e kemi klasifikuar në grupet gjegjëse për çdo njësi toponimike. I kemi veçuar sipas shtratit të gjuhës, origjinës dhe kuptimit semantik që e karakterizon atë mikrotoponim. Numrin më të madh të njësisve toponimike e përbëjnë oronimet, kurse sipas përbërjes shumica e mikrotoponimrvr janë togëfjalësha si psh: Livadhi Madh, Kodra e Dushkut etj.

Sipas origjinës pjesa më e madhe e mikrotoponimeve kanë origjinë iliro-shqiptare, gjë që e vërtetojnë autoktoninë e këtyre trojeve ndërshekuj.

SUMMARY

Onomastics as an important branch of lexicology for me has always awakened a special interest, always wanting to learn more about the meaning and origin of distinctive names such as personal names, nicknames or pseudonyms (anthroponyms). And family names or surnames that we call them (patronyms).

After the finding of each toponymous unit, we have tried to classify them in families of words such as: hydronyms, ornames, winnings, zoonyms, metals, cult objects, traffic. Each microtopic is of importance in our language conglomerate. Onomastics for each language is a good subject that can greatly satisfy the lack of written documents as a verbal archive of the history and antiquity of any society.

Since the time of my studies, the onomastic field has constantly kept my interest in deepening within a relatively explored territory from the linguistic point of view. This phenomenon waved us even more interest in entering the world of discovery of the language treasure.

The importance of microtopics for the subject of linguistics is as interesting as fossil revelation for archeology. Our ambitions in this area were rampant when we knew we were dealing with an unexplored space before because no research of this nature had been done before. Practicing the empirical method in the field and collecting data through questionnaires makes our work more relevant.

Villages: Gjurgjevisht, Llomnicë, Kalisht and Gorjan we visited and contacted with many informants living in these areas. Then we have classified the coated material into the respective groups for each toponymic unit. We have singled out on the bed of language, origin, and semantic meaning that characterizes it microtoping. The largest number of toponymy units are the oronyms, and most of the microtoponyms are composed of such as the Great Meadows, Oak Hill, etc.

Originally, the majority of microtoponyms originate from Illyrian-Albanian origin, which confirm the autochthony of these inter-ethnic territories.

РЕЗИМЕ

Ономастика како важна гранка на лексикологијата за мене секогаш разбуди посебен интерес, секогаш сакайки да научам повеќе за значењето и потеклото на Посебните имиња како лични имиња, прекари или псевдоними (anthroponyms). И семејните имиња или презимињата што ги нарекуваме (патроними).

По наоѓање на топонимите, ние се обидовме да ги класифицираме во семејствата на зборовите како што се: хидроними, ороними, зооними, метали, култни објекти, сообраќајот и тн. Секој микротопоним е важен во нашиот јазичен конгломерат. Ономастиката за секој јазик е добар предмет кој, во голема мера може да го задоволи недостатокот на пишани документи како вербална архива на историјата и антиката на секое општество.

Од времето на моите студии, ономастичното поле постојано го задржа мојот интерес за пролабочување на релативно истражуваната територија од лингвистичкиот поим. Овој феномен ни мавташе уште поголем интерес за да влеземе во светот на откривањето на јазичното богатство.

Важноста на микро-топоними за предметот на лингвистиката е исто толку интересна како фосилно откровение за археологијата. Нашите амбиции во оваа област беа неконтролирани кога знаевме дека се занимаваме со неистражен простор, затоа што досега не било направено истражување од оваа областа. користејќи на емпирискиот метод на истражување на терен и собирањето на податоците преку прашалници ја прави нашата работа порелевантна.

Села: Ѓурѓевиште, Ломница, Калиште и Горјан, ги посетивме и контактиравме со многу информатори кои живеат во овие краишта. Потоа го класифициравме обложениот материјал во соодветните групи за секоја топонимичка единица. Ние го издвоивме потеклото и семантичкото значење што го карактеризира микроповрзувањето. Најголем број единици на топоними се оронимите, а повеќето од микротопонимите се составени од група на зборови како заменки и именки пр: Големите ливади. Гури Ыкут и др.

Според истражуваната, можеме да констатираме дека поголемиот дел од микротопонимите потекнуваат од илирско-албанско потекло, што ја потврдува автохтонијата на овие меѓуетнички територии.

VËRTETIM

Kandidati për shkallën master në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, Zijad Shabani dorëzoi për redaktim gjuhësor (lekturim) tezën “Onomastika e fshatrave malore të Komunës së Vrapçishtit (Gjurgjevisht, Llomnicë, Kalisht, Gorjan)”, udhëhequr nga mentori Prof. Dr. Zeqir Kadriu . Pas redaktimit gjuhësor (lekturimit) vërtetohet se e njëjta i plotëson kriteret gjuhësore e drejtshkrimore të gjuhës së sotme standarde shqipe dhe mund të shkojë në procedurë të mëtutjeshme.

Shkup, 5.07. 2018 Prof.Dr. Xhemaludin Idrizi

